



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KP.nr.475/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje Ekonomike, me gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbarimore të kreditorit: Kompania e Mbeturinave “Pastrimi” me seli në Prishtinë, kundër debitorit: I...me numër të biznesit të cilin e përfaqëson drejtori A.R. nga fshati, Komuna e Lipjanit, që ka të bëjë me pagesën e borxhit, si objekt i përmbarimit, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar kundër Urdhrit të Përmbaruesi Privat Eset Murati P.nr.197/2020 të dt:25.02.2020, mbi caktimin e përmbarimit, me dt:18.08.2022, jashtë seance merr këtë:

A K T V E N D I M

I. Aprovohet, prapësimi i debitorit I...me numër të biznesit të cilin e përfaqëson drejtori A.R. nga fshati, Komuna e Lipjanit, i ushtruar kundër Urdhrit të Përmbaruesit Privat P.nr.197/2020 të dt:25.02.2020, **si i bazuar**.

II. Përfundohet, procedura përmbarimore KP.nr.475/22 dhe **abrogohen** të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë çështje përmbarimore.

III. Shpenzimet e procedurës së përmbarimit bien në barrë të kreditorit të përmbarimit.

A r s y e t i m

Përmbaruesit privat në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm–Ekstraktit të verifikuar të nga librat afariste të kontabilitetit me numër ID i cili paraqet dokument përmbarues në bazë të nenit 21 dhe nenit 29 par.1.3 të LPP-së.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur prapësim, me të cilin ka deklaruar se meqenëse ne nuk kemi kontratë për mbeturinat me Kompaninë “

Pastrimi” Sh.a, e njëjta ka lidhur kontratë të njëanshme pa na njoftuar neve si Kompani, po ashtu e njëjta nuk na ka njoftuar lidhur me faturat për borxhin e pretenduar.

Me tej debitori i përbarimit kishte theksuar se megjithatë ne si kompani pas pranimit të faturave nga kreditori i përbarimit kemi përmbushur obligimin e në shumën 55.60 Euro, gjë që si provë prapësimit i është bashkangjitur konfirmimi i bankës e cila prove gjendet në shkresat e lëndës.

Nga provat e bashkangjitura në prapsim debitori i përbarimit i kishte propozuar Gjykatës të miratohet prapësimi i debitorit dhe Urdhri i Përbaruesit Privat Eset Murati nga Prishtina me numër P.nr.197/2020 i datës 25.02.2020 të shfuqizohet dhe hiqen të gjitha veprimet e ndërmarra.

Kundër prapësimit të debitorit, kreditori kishte ushtruar përgjigje në prapësim me të cilin ka shtuar se pretendimet e debitorit të theksuara në prapsim janë të pa mbështetura në asnjë provë, kjo për faktin se me Rregulloren për shërbime Komunale janë paraparë obligimet, autorizimet dhe kushtet për të gjitha subjektet rreth mirëmbajtës së higjienës publike në qytet. Tutje kreditori kishte deklaruar edhe përkundër kryerjes së shërbimeve të bartjes së mbeturinave, debitorit të përbarimit për çdo muaj ishin dërguar faturat për shërbimet e kryera, mirëpo i njëjti kishte injoruar inkasantët e kreditorit për t’i pranuar faturat e lartpërmendura.

Kreditori i përbarimit në përgjigje në prapsim ka deklaruar se kundërshtimet e debitorit janë të pa bazuara, prandaj i kishte propozuar gjykatës që Urdhri përbarimor i lejuar nga përbaruesi privat të mbetet në fuqi dhe të refuzohen kundërshtimet e debitorit si të pa bazuara.

Gjykata, bëri shikimin e shkresave të lëndës, analizoi pretendimet e debitorit në prapësim, dhe vlerësoi se prapësimi është i bazuar, ngase në shkresat e lëndës konstatohet se debitori ka përmbush detyrimin në mënyrë vullnetare, pra me transferin të lëshuar ngavërtetohet se pagesa e borxhit të lartcekur ishte paguar me datë 05.03.2020 dhe atë në shumën prej 55.60, prandaj gjykata vlerësoj se pretendimet e debitorit në prapësim, sa i përket përmbushjes së detyrimit janë të qëndrueshme, andaj të njëjtin e aprovoj si të bazuar.

Ndërsa sa i përket shpenzimeve të përbarimit gjykata vlerësoi se debitori i përbarimit borxhin e kishte përmbushur në afatin partitiv, pra në rastin konkret debitori e kishte përmbushur detyrimin para afatit siç është përcaktuar me nenin 40 par. 1 pika 1.2, andaj duke u mbështetur në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës Gjykata vendosi që shpenzimet e procedurës së përbarimit t’i bart kreditori i përbarimit siç është përcaktuar në nenit 13 par.1 të LPP-së ku thuhet citoj “ *shpenzimet e procedurës lidhur me caktimin dhe kryerjen e përbarimit paraprakisht i paguan kreditori.*

Nga arsyet e paraqitura, e në bazë nenin 43 par. 4 dhe 73 të LPP-së si dhe për Plotësim Ndryshimin e ligjit e me numër Nr.05/L-118 te ligji 04/L-139 për Procedurën Përmbaremore, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm

KP.nr.475/22, dt.18.08.2022

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.